



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Makroekonomisë përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Sektori Real

Nr.10, Korrik - Shtator 2012

Ekonomia vendore vlerësohet të jetë rritur me rreth **3.9%**¹ gjatë vitit 2012. Përderisa të dhënat aktuale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se gjatë vitit 2011 rritja ekonomike shënoj **4.5%**.

Katalizator kryesorë në rritjen ekonomike vlerësohet të jenë **konsumi i përgjithshëm**, duke kontribuar në rritje me rreth 3.9%, pasuar nga investimet e përgjithshme, kontributi i të cilës vlerësohet të jetë rreth 2.5%.

Çmimet e përgjithshme, siç mund të shihet nga grafiku, pas një ngritje të theksuar gjatë vitit 2011 u stabilizuan gjatë këtij viti. Megjithatë, presionet inflacioniste gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 ishin më të theksuara.

3.1% në mesatare u shënuar ngritje në ICK për gjatë këtij tremujori, për dallim nga tremujori i dytë ku çmimet në mesatare shënuan ngritje me të ulët, rreth 1.3%.


Përgjatë këtij tremujori, ngritje e çmimeve vërehet në naftë dhe benzinë, duhan, rrymë dhe perime. Përderisa rënie në çmime vërehet në bukë, drithëra dhe shërbime telefonike.

Si rezultat i zhvillimeve në çmimet e mallrave nëpër tregjet globale, parashikimet e fundit për nivelin e përgjithshëm të çmimeve botërore tregojnë për një stabilizim të përgjithshëm të çmimeve, mirëpo, ky stabilizim është në një nivel relativisht të lartë. Çmimet e ushqimit priten të jenë nxitësit kryesor në luhatjen e çmimeve gjatë periudhës së parashikuar si rezultat i peshës së madhe që këto të mira kanë në shportën e konsumatorit vendorë.


Si rezultat i zhvillimeve gjeo-politike në lindjen e mesme dhe më gjerë, lëvizjet e çmimeve të naftës dhe benzinës priten të jenë një faktor shtesë i rëndësishëm në determinimin e nivelit të çmimeve vendore përgjatë vitit.

Si rezultat i këtyre ngjarjeve dhe zhvillimeve në tregun vendorë, parashikohet se çmimet vendore përgjatë

Rritja vjetore e BPV -së, në përqindje (%)



Indeksi i Çmimit të Konsumatorit, IÇK (në %)



¹ Të gjitha supozimet ekonomike që mbështesin vlerësimet e lartpërmendura janë përpiluar në bazë të vrojimit të dhënave të disponueshme deri në Qershor 2012.

vitet 2012 priten të rriten me një mesatare prej **2.5%** në raport me vitin 2011.

Sektori i Jashtëm

Eksportet e mallrave edhe gjatë këtij tremujori vazhduan ritmin rënës të treguar përgjatë këtij viti. Përderisa tek mallrat e importuara vërehet vetëm një ngadalësim në rritjen e mallrave të importuara.

Vlera e eksporteve të mallrave gjatë tremujorit të tretë shënoj rreth €67.8 milionë, vlerë e cila është më e ulët për rreth €10.7 milionë në raport me tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

Vlera totale e mallrave të eksportuara në fund të muajit shtator 2012 arriti në rreth €202 milionë.

Sikurse gjatë viteve paraprake, **metalet bazë** ishin produktet kryesore të **eksportuara**, pasuar nga produktet e mineraleve, produktet ushqimore, plastika dhe druri, makineritë dhe pajisjet elektrike.

Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtë sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e **BE-së** mbesin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.

Importet e mallrave vazhduan të ngriten. Tremujori i tretë shënoj 8.4% ngritje në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, ku vlera e mallrave të importuara në tremujorin e tretë shënoj rreth €725 milionë.

Deri në fund të periudhës raportuese (shtator, 2012)

vlera e mallrave të importuara arriti në €1.8 miliardë. Kjo vlerë është më e lartë për rreth 4.3% se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga ushqimi i përgatitur, pijet, duhani dhe pajisjet makinerike.

Si rezultat i performimit më të zbehtë të eksporteve dhe mos ndryshimit të sasisë së importuar, bilanci tregtar nuk ka shënuar përmirësim gjatë kësaj periudhe.

Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme për tremujorin e tretë të vitit shënuan ngritje të theksuar. Kjo ngritje u shënu si rezultat i ngadalësimit të të hyrave gjatë tremujorit paraprak, shkaktuar nga ngadalësimi i importit.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit, **të hyrat e përgjithshme** shënuan **€477.3** milionë, duke përfaqësuar një ngritje prej rreth **30%** në raport me tremujorin e dytë të vitit.


Kjo ngritje e theksuar erdhi si rezultat i përpos ngritjes në të hyrat e rregullta, disbursimit të mjeteve në korrik dhe shtatorë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Të **hyrat nga Dogana**, si burim kryesor i të hyrave të përgjithshme, përgjatë tremujorit të tretë të vitit shënuan €247.5 milionë, shifër e cila është më e lartë për rreth 3.6% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar dhe 17% më të larta se sa tremujori i dytë i vitit.

Importi, eksporti dhe bilanci tregtar, në miliona euro



Të hyrat buxhetore, në milion euro



Përderisa **tatimet vendore**, të arkëtuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, shënuan rënie prej rreth 5% në raport me vitin e kaluar duke shënuar vlerë prej rreth €68.2 milionë përgjatë tremujorit të tretë të vitit.


Shpenzimet e përgjithshme shënuan ngritje gjatë këtij tremujori për të arritur shumën prej **€366.4** milionë. Kjo shifër njëherazi përfaqëson një ngritje prej rreth 8.1% në raport me tremujorin paraprak.

Shpenzimeve kapitale gjatë tremujorit të tretë të vitit ishin më të larta për rreth 28% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak.

Shpenzimet rrjedhëse shënuan rënie në krahasim me periudhat paraprake. 2.5% ishte rënia në raport me tremujorin paraprak dhe rreth 1% rënie në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Ndërsa, në fund të muajit shtator, shpenzimet totale kapën shumën prej €992 milionë duke shënuar një ngritje prej 9.9% në raport me shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në miliona euro



Sektori Financiar

Asetet totale të sektorit bankar në fund të muajit shtator të vitit 2012 arritën në €2.7 miliardë, shifër e cila përfaqëson një ngritje për **5%** në krahasim me periudhën e njëjtë të vitin 2011.

Depozitat në sektorin bankar në fund të tremujorit të tretë të vitit shënuan €2.2 miliardë, shifër e cila është më e lartë për 4.6% në raport me tremujorin e dytë të vitit dhe 5.2% më të larta në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Kreditë arritën vlerën prej **€1.7 miliardë** në fund të muajit shtator 2012 duke shënuar një ngritje vjetore prej **6.2%**.

Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve (71.7%), energjetikës, industrisë dhe ndërtimtarisë (24.7%) dhe sektori i bujqësisë (3.6%).

Norma mesatare e **interesit në kredi** përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 shënoj **13.80%**, ndërsa norma mesatare e **interesit në depozita** shënoj **3.73%**.

Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Tabela 1. Agregatet kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2012								
	I			II			III		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
<i>(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)</i>	<i>(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)</i>								
Rritja vjetore e BPV -së									
Sektori Real									
IÇK (në %)	2.9	1.7	0.6	1.2	1.1	1.7	2.2	3.1	4.1
Projeksioni I IÇK-së (në %)									
Sektori i jashtëm									
Importi i Mallrave	132.2	125.2	200.2	215.2	231.9	217.5	234.9	237.3	253.6
Eksporti i Mallrave	19.2	15.3	23.9	20.7	24.9	29.9	25.5	20.2	22.1
Bilanci tregtar	-113.0	-109.9	-176.3	-194.5	-207.0	-187.6	-209.4	-217.1	-231.5
Sektori Fiskal									
Të hyrat e përgjithshme	93.4	82.0	111.9	103.7	115.4	143.5	222.6	119.7	135.0
Të hyrat nga kufiri	40.1	45.7	56.8	63.6	75.1	72.8	82.5	88.4	76.6
Të hyrat vendore	29.3	20.1	15.3	35.4	18.6	16.3	31.4	20.6	16.2
Të hyrat jo tatimore	3.4	2.3	3.5	3.7	4.1	3.1	4.4	3.9	3.4
Te hyrat nga dividenta	-	-	15.0	-	-	10	-	-	0.0
Mbështetja buxhetore	1	-	-	-	-	36.7	-	-	-
Kreditë (disbursimet)	10.0	9.9	9.9	0.0	5.0	0.0	67.9	0.0	23.7
Shpenzimet e përgjithshme	30.1	148.2	108.4	80.6	131.6	126.7	118.4	116.4	131.7
Shpenzimet Rrjedhëse	22.7	73.1	81.1	72.5	74.6	76.7	67.9	71.9	78.6
Shpenzimet Kapitale	7.4	75.1	27.3	8.1	57.0	50.0	50.4	44.5	53.1
Remitancat			119.1			142.4		175.2	
Sektori Financiar									
Depozitat	2,113.5	2,123.4	2,087.5	2,078.3	2,097.0	2,108.5	2,171.1	2,222.8	2,206.5
Kreditë	1,683.1	1,692.2	1,717.1	1,740.8	1,755.3	1,776.3	1,767.1	1,753.8	1,758.7
MHN te korporatave financiare			2,087.9			2,081.2		2,301.6	

Burimi i të dhënave:

Sektorit Real dhe Sektori i Jashtëm: Enti i Statistikave të Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>

Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MEF: <http://www.mef-rks.org/>

Sektori Financiar: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>